

Për arsye se të dielën e kaluar, shkolla nuk na ka lejuar të marrim materialet mësimore, ne do të ua dërgojmë nxënësve materialet e reja si paketë me postë.

Brenda në paketë gjendet një zarf, të cilin duhet ta përdorni për t'ia dërguar mbrapsht materialet (fletët e punuara, por jo fletoret e detyrave), për t'u korrigjuar.

Faqet e fletoreve me detyrat e punuara mund t'i dërgoni foto me E-Mail tek mësuesja kujdestare e klasës.

Fatkeqësisht për arsye të drejtave të autorit, jo të gjitha materialet mësimore dixhitale na lejohen t'i përdorim. Në rubrikën

"Materialdownloads" do të gjeni materiale dhe linke të përzgjedhura, të cilat mund t'i përdorni.

Klasa e katërt fillon mësimin me datë **04 maj**. Për mënyrën, sesi do të zhvillohet mësimi, akoma nuk jemi të informuar nga Ministria e Arsimit.

Përsa i përket klasave të tjera, deri tani nuk ka informacion, se kur edhe në çfarë mënyre do të rikthehen në mësim.